

Home > Aktualitet > Finalizohet operacioni ‘Piramida’, ishin pjesë e grupit kriminal në Korçë, arresto...

AKTUALITET

Finalizohet operacioni ‘Piramida’, ishin pjesë e grupit kriminal në Korçë, arrestohen për trafik droge 7 persona

Operacioni për kapjen e tyre është zhvilluar pas një hetimi nga prokuroria dhe drejtoria e policisë Korçë. Pas ndalimit atyre u është dhënë masa e “arrestit ne burg” nga gjykata.



Policia Korce

5 Shkurt, 2021 8:40

KORÇË– Shtatë persona janë ndaluar ditën e sotme për trafik droge në Korçë. Operacioni për kapjen e tyre është zhvilluar pas një hetimi nga prokuroria dhe drejtoria e policisë Korçë. Pas ndalimit atyre u është dhënë masa e “arrestit ne burg” nga gjykata.

Në pranga ranë 2 transportuesit e kanabisit, Ahmetion Myslimi dhe Mariglen Arapi, organizatori i trafikut Mario Tanellari, i dënuar edhe më parë për drogë. Arrestohen edhe poseduesit e kanabisit, Xheljan Ajdini, Elvi Tahiri, Niko Janko e Mikail Mejdi.

Policia sekuestroi 1 armë gjahu, sasi e dyshuar narkotike kanabis, automjete, celularë, sasi në lekë dhe euro. Në pranga ranë A. M., 23 vjeç, banues në Çiflig, Korçë (në rolin e transportuesit), M. A., 32 vjeç, banues në Pojan, Maliq (në rolin e transportuesit), M. T., 37 vjeç, banues në Moravë, Korçë (i dënuar më parë për prodhim dhe shitje narkotikësh, në rolin e organizatorit të grupit), Xh. A., 28 vjeç, banues në Korçë (në rolin e poseduesit). E. T., 39 vjeç, banues në Korçë (me precedent të mëparshëm penal në fushën e krimeve kundër jetës, subjekt i OFL-së për të deklaruar pasurinë, në rolin e poseduesit), N. J., 53 vjeç, banues në Moravë, Korçë (në rolin e poseduesit), si edhe u arrestua në flagrancë shtetasi M. M., 33 vjeç, banues në Borovë, Kolonjë (në rolin e poseduesit).

Në cilësinë e provës materiale në ngjarjet që grupi kishte marrë pjesë u sekuestruan në total 23 kg e 600 gr sasi e dyshuar narkotike kanabis; 6 gr lëndë e dyshuar narkotike kokainë; 1 armë gjahu teke; 7 automjete; 16 celularë; sasi në lek dhe euro.

Për më shumë bëhu pjesë e grupit më viral në Facebook, [Dosja.al](#)

NJOFTIMI:

KorçëFinalizohet operacioni policor “Piramida”.Operacioni, në vijim të dy operacioneve antidrogë të finalizuar më parë “Lapidari” dhe “Pusteci”, pas një hetimi disa mujor, zhvilluar nga Seksioni për Trafiqet e Paligjshme dhe Narkotikët në DVP Korçë, Prokuroria, Policia Kufitare Korçë në bashkëpunim me Forcat e Posaçme Operacionale në Policinë e Shtetit.Goditet një grup i strukturuar kriminal, në fushën e trafikimit të lëndëve narkotike dhe shpërndarjes të drogave të forta në qarkun e Korçës.

Shkon në 12 numri i të ndaluarve, vihen në pranga edhe 7 persona të tjerë (organizatori i grupit, poseduesit dhe transportuesit e lëndëve narkotike), bashkëpunëtorë me 5 të arrestuarit më parë nga Policia.Sekuestrohen 1 armë gjahu, sasi e dyshuar narkotike kanabis, automjete, celularë, sasi në lekë dhe euro.Seksioni për Hetimin e Trafiqeve të Paligjshme dhe Narkotikëve në Drejtorinë Vendore të Policisë Korçë, nën drejtimin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Korçë, në bashkëpunim me Policinë Kufitare Korçë dhe Forcat e Posaçme Operacionale pranë Policisë së Shtetit, pas një pune intensive hetimore disa mujore, finalizuan me sukses operacionin e koduar “Piramida”, si rezultat i të cilit u bë ndalimi, në bazë të vendimeve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë e cila ka caktuar masën e sigurisë “Arrest në burg” për shtetasit:

A. M., 23 vjeç, banues në Çiflig, Korçë (në rolin e transportuesit).

M. A., 32 vjeç, banues në Pojan, Maliq (në rolin e transportuesit).

M. T., 37 vjeç, banues në Moravë, Korçë (i dënuar më parë për prodhim dhe shitje narkotikësh, në rolin e organizatorit të grupit).

Xh. A., 28 vjeç, banues në Korçë (në rolin e poseduesit).

E. T., 39 vjeç, banues në Korçë (me precedent të mëparshëm penal në fushën e krimeve kundër jetës, subjekt i OFL-së për të deklaruar pasurinë, në rolin e poseduesit).

N. J., 53 vjeç, banues në Moravë, Korçë (në rolin e poseduesit).

Si edhe u arrestua në flagrancë shtetasi M. M., 33 vjeç, banues në Borovë, Kolonjë (në rolin e poseduesit).

Falë një pune intensive hetimore dhe provave të grumbulluara, u bë e mundur që në fazën e dytë të operacioneve “Lapidari” dhe “Pusteci”, të finalizuar më datë 08.11.2020, 14.01.2021, në Vithkuq-Korçë dhe Cerje-Pustec, si edhe ngjarjes së ndodhur më datë 08.06.2020, në Kolonjë, të dokumentohej me prova ligjore, implikimi i 7 shtetasve të lartpërmendur në aktivitetin e paligjshëm që ushtronte ky grup i strukturuar kriminal.

Konkretisht lidhur me operacionin e koduar “Pusteci”, si rezultat i të cilit u arrestuan në flagrancë shtetasit R. N. dhe I. M. dhe u sekuestrua në cilësinë e provës 21 kg e 500 gr, lëndë e dyshuar narkotike kanabis, nga hetimet e kryera rezultoi se transportues të lëndës narkotike përveç dy të arrestuarve ishin edhe shtetasit A. M., dhe M. A. Në rolin e organizatorit të këtij grupi rezultoi të jetë shtetasi M. T., dhe posedues të sasisë së lëndës narkotike shtetasit Xh. A. dhe E. T. Në lidhje me operacionin “Lapidari”, si rezultat i të cilit u arrestuan në flagrancë shtetasit A. B. dhe A. Q. dhe u sekuestrua 2 kg e 100 gr lëndë e dyshuar narkotike kanabis, u dokumentua se lënda narkotike ishte blerë për shtetasin M. T. Si edhe në lidhje me ngjarjen e datës 08.06.2020, ku në Kolonjë u arrestua në flagrancë shtetasi S. Xh. dhe u sekuestrua 6 gr lëndë e dyshuar narkotike kokainë, u dokumentua se të implikuar në këtë ngjarje ishin shtetasit N. J. dhe M. M., në lokalitë e të cilit në Ersekë, Policia gjeti dhe sekuestroi një sasi të dyshuar narkotike kanabis. Në cilësinë e provës materiale në ngjarjet e mësipërme u sekuestruan në total 23 kg e 600 gr sasi e dyshuar narkotike kanabis; 6 gr lëndë e dyshuar narkotike kokainë; 1 armë gjahu teke; 7 automjete; 16 celularë; sasi në lek dhe euro.

Materialet në ngarkim të tyre i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë për veprime të mëtejshme.

(A.B)/Dosja.al

ETIKETA:

#7 te arrestuar ne korce

8

SHARES



Previous article

‘Po i rrezikon vendin Elisës me gjithë këto...’/ Intervista e FATOS NANOS bën “NAMIN” në rrjet, akuzat për ‘lëpirje’ ndaj Ramës, të tjerë ndjejnë nostalgji. Braçe se mban dot veten

Next article

Kërkojnë votëbesim më 25 prill, sot PD prezanton planin e radhës! Fokus i tek rinina

Shto Koment

Emri Juaj*

E-Mail*

Komenti Juaj*

Dërgo

POSTIME TË NGJASHME

Aktualitet




Kryediplomanti i Maqedonisë së Veriut, Bujar Osmani viziton sot Tiranën, konferencë për...

Aktualitet



Ishin pjesë e ‘Bandës së Krishtlindjeve’/ Dy shqiptarët bënë ‘namin’ me vjedhjet në Itali,...

Aktualitet



Pasaportat COVID-19: Rrugë drejt normalitetit apo krijimit të problemeve të reja?

Aktualitet



Intervista e Fatos Nanos! Titujt kryesorë të portaleve, 5 shkurt 2021

Stafi

Drejtor : Enton Abilekaj
Kryeredaktor : Fjola Graçi

Gazetarë :

Kejsi Muça
Riviera Gjyl
Anila Kolgjini
Klea Alushi
Kleida Muka

Florida Mingla
Dezdemona Kolaveri
Alberta Boseta
Izmir Akulli



STAY CONNECTED

f Facebook

LIKE

t Twitter

FOLLOW

i Instagram

FOLLOW

y Youtube

SUBSCRIBE

LAJMET E FUNDIT




5 Shkurt, 2021 8:59

Alizoti: Humbja e zgjedhjeve do ishte tragjedi për Shqipërinë, se sa për PD dhe Bashën




5 Shkurt, 2021 8:55

Kryediplomanti i Maqedonisë së Veriut, Bujar Osmani viziton sot Tiranën, konferencë për shtyp me Xhaçkën



5 Shkurt, 2021 8:55

A do punoni ju apo si këta?/ Osami i përgjigjet qytetares në Ferizaj: Mos na lini asnjë ditë po nuk realizuar planin



5 Shkurt, 2021 8:54

Kryemadhi komenton ‘rrjedhjet’ nga LSI: Rahovica s’e meritonte të ishte deputet, Nasip Naçon dy herë e kam takuar



Aleanca për
Media
Etike

Artikull joetik?

raporto këtu